



**PERMBLEDHJE JO TEKNIKE  
VLERESIM TE NDIKIMIT NE MJEDIS  
(Shtojca II, Pika 6, (b) )**

**PROJEKTI I PROPOZUAR: PRODHIM I PRODUKTEVE  
FARMACEUTIKE**

**VENDODHJA: FSHATIN KOXHAS, BASHKIA SHIJAK, (QARKU  
DURRES)**

**Informacion mbi Projektin:**

**Titulli i projektit:** Vlerësim i Ndikimit Mjedisor (Procedura paraprake)

**Emri i raportit:** Prodhim i produkteve farmaceutike

**Investitor:** NOVAL.SHPK

**Subjekti ndertues:** ANA.Sh.p.k

**Bashkeautor:** Fatjona Levani (PF)

**Data e këtij raporti:**

Tirane Maj 2018

**Aprovuar:**

*Fatjona Levani*

Fatjona Levani

Ekspert i Licensuar



LN-3492-07-2017(NIPT: L52227035P)

Vleresues i Ndikimit ne Mjedis dhe Auditues Mjedisor

**Tabela e raportit paraprake te VNM:**

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME .....	2
1.1 Përshkrimin e projektit të propozuar, te cilin e kemi pergatitur dhe bashke-emeluar "Pershkrimi i projekt zhvillimit" te gjitha dokumentat me nenzera perkatese te perfshira ne ku perfshihen keto informacione dhe te dhena teknike si: .....	4
1.2 Përshkrim i shkurter per kapitujt e Raportin paraprak te VNM-se, ku perfshihen:.....	5
2. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE .....	6
2.1. Hyrje.....	6
2.2. Vlerat ekologjike (flora dhe fauna) .....	6
3. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ. ....	7
3.1. Burimet ujore ne zone .....	7
4. IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR, PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE SI DHE INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA, .....	9
4.1. Ndikimet e mundshme mjedisore .....	9
5. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË .....	12
6. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË). .....	14

**1. TE DHENA TE PERGJITHSHME**

Ky raport paraprake VNM se bashku me kerkesen dhe dokumentacionit shoqërues nga ana e zhvilluesit "NOVAL"Sh.p.k do te paraqiten në AKM per perbledhje jo teknike e VNM e cila do te percjell dokumentacionin në AKM per marrjen e Lejes Mjedisore tipi B nga AKM per nenshtrimit te procedurave paraprake te VNM per projektin: "Prodhim te produkteve Farmaceutike, me vendodhje ne Koxhaj, Bashkia Shijak, Rrethi Durres, Qarku Durres.

Zhvilluesi "Noval"Sh.p.k, që synon të zbatojë kete projekt qe eshte ndertuar nga subjekti Ndertimor ANA.Shpk, me subjektin ndertues A&I Design.sh.p.k dhe pronareve te prones Motor.EL Shpk Ndertim te nje objekti "Strukture: Kapanon 2 kat, sipas studimit te realizuar, miratuar me Vendim VNM me date 11.05.2015.

Zhvilluesi Noval.Sh.p.k ne rolin edhe te investitor ku administratori eshte pronari i pronave ku do te zhvillohet veprimtaria, kerkon te dorezoj kete **RAPORT PARAPRAK TE VNM –SE** per miratim me Vendim te AKM te per projektin :

*"Prodhim te produkteve Farmaceutike" Vendodhja: Koxhaj, Bashkia Shijak, Rrethi Durres, Qarku Durres*

Ne kete raport teknik po paraqesim nje permbledhje te pjeses teknike te projektit me te dhenat si me poshte:


Ne tabelen e meposhtme jane dhene treguesit kryesore tekniko te projektit ne zhvillim:

Nr rendor	Emeriimi i treguesve	Njesia e matjes	Sasia
A. Permasat e projektit			
1.	Siperfaqe e tokes qe zhvillohet	m <sup>2</sup>	10 469
2.	Siperfaqe e tokes e zene me ndertim	m <sup>2</sup>	4 407
	Numri i kateve mbi toke	Kate	1-2
	Numri i kateve nentoke	Kate	0

Projekti ne vleresim , i cili është subjekt i kërkesave të nenit 8 të ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, SHTOJCA II(Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis), pika 6, nenpika b , i cili përmban si pershkrim projekti si me poshte:

Përshkrim I linjave të prodhimit të cilat janë të parashikuara të vendosen në punë në fabrikën e prodhimit NOVAL.

**Procesi i prodhimit farmaceutik**



Linjat e prodhimit të planifikuara janë:

1. Linja e prodhimit steril e cila do ketë produkte
  - Ampula 7500 – 9000 ampula / orë
  - Shiringa të mbushura paraprakisht 7500 – 9000 shiringa / orë
  - Solucione oftalmike 3000 – 5000 shishe/ orë
2. Linja e prodhimit të formëdozave të ngurta
  - Tableta 25000 – 70000 tableta / orë
  - Kapsula 25000 – 70000 kapsula / orë
  - Bustina 10000 bustina / orë
3. Linja e produkteve gjysëm të ngurta
  - a. Kremra 1000 njësi / orë
  - b. Pomadave 1000 njësi / orë
  - c. Xhele 1000 njësi / orë
4. Linja e tretësirave për
  - Përdorim oral 1000 – 2000 shishe / orë
  - Përdorim të jashtëm 1000 – 2000 shishe / orë

**1.1 Përshkrimin e projektit të propozuar, te cilin e kemi pergatitur dhe bashke-emeluar “Përshkrimi i projekt zhvillimit” te gjitha dokumentat me nenzero perkatese te perfshira ne ku perfshihen keto informacione dhe te dhena teknike si:**

- a) përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar
- b) planimetria e vendndodhjes së projektit ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë së projektit;
- c) informacioni për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna) që administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit
- d) përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit ;
- dh) informacioni për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja ;
- e) programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit (Relacioni);
- f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- g) informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit((raporti i VNM-se ne vleresim);

- gj) informacioni për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret (relacioni teknik);
- h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre (relacioni teknik);
- i) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si: ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj (relacioni teknik);
- j) informacioni për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit (Kërkesa e subjektit + dokumentacioni teknik + kontrata).

## 1.2 Pershkrim i shkurtër për kapitujt e Raportin paraprak të VNM-se, ku përfshihen:

Ky raport paraprak i VNM është përgatitur në përputhje me Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.686, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis" ku specifikisht Kreu I (Zhvillimi i procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis) si me poshtë sqaruar:

**Fazat e procedurës paraprake të VNM-së:** Procedura paraprake e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) zbatohet për projektet që janë subjekt i kërkesave të nenit 8 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, dhe kalon në këto faza të njëpasnjëshme:

- a) Paraqitja e kërkesës për Konsultim me publiku në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);
- b) Konsultimi i AKM-së me institucionet e tjera dhe publikimi i kërkesës;
- c) Marrja e mendimeve nga pushteti vendor dhe mendimi i komunitetit të zones.

## Raportin paraprak të VNM-se që do përgatitet për Leje Mjedisore Tipi B, ku përfshihen:

Kapitulli 1: Te dhëna të përgjithshme për projektin

Kapitulli 2: një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me imazhe;

Kapitulli 3: informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

Kapitulli 4: një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër; një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve; informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

Kapitulli 5: të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Kapitulli 6: mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, përfshi edhe kthimin e tokës bujqësore (në rast se përdorimi ekzistues është i tillë) dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Kapitulli 7: masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Kapitulli 8: ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);

Kapitulli 9: certifikatën dhe licencën përkatëse të QKL-së, të specialistit që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.

## 2. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE

### 2.1. Hyrje

*Zona ku shtrihet zhvillimi i projektit ne vleresim ( Prodhim i produkteve farmaceutike) vleresohet si zone jo me status te vecant si Zone e Mbrojtur pra nuk ndikon apo ben pjese ne Zona te Mbrojtura Mjedisore. Ne baze te verifikimit ne terren dhe vleresimit disa javor ne kete prone mund te percaktojme nje informacion te detajuar se ne kete prone nuk ndodhen specie te rrezikuara e cila vleresohet si zone industrialeku sot ekzistojne industrial.*

*Qyteti i Durres shtrihet në një luginë rreth 40 km larg detit dhe në një lartësi mbi 100 metrash. Ka një klimë mesdhetare me verë të ngrohtë dhe të nxehtë e me një sasi reshjesh 1200 mm gjatë dimrave të butë. Temperatura vjetore mesatare është 16°C në muajin më të ftohtë, janarin, me temperaturë 6°C dhe korrikun si periudha më e ngrohtë, me një temperaturë mesatare 24°C. Afërsia e maleve të lartë në lindje të qytetit bën që të dominojnë erërat me drejtim veri-perëndim dhe jug-perëndim.*

Kështu, qyteti është rritur përtej zonës së tij të zhvillimit të planifikuar urban. Shërbime të domosdoshme, si furnizimi me ujë e energji, nuk i përgjigjet kërkesave. Menaxhimi i mbeturinave, si të lëngshme dhe të ngurta, përbën dhe aspektin më të dukshëm të ndotjes mjedisore në Durres.

Ka diskutime në lidhje me shifrat e sakta të rritjes së popullsisë në Durresit. Megjithatë, nga pikëpamja mjedisore (dhe e dhënies së shërbimeve), çështja nuk ka të bëjë me përcaktimin e saktë sasior të rritjes, por me aftësinë për ta menaxhuar këtë rritje. Kapaciteti mjedisor mbajtës i çdo zone është një funksion i kapacitetit të tij të menaxhimit mjedisor.

### 2.2. Vlerat ekologjike (flora dhe fauna)

**Për sa u përket vlerave ekologjike (Flora dhe Fauna):** *Edhe urbanizimi i planifikuar dhe i mirë menaxhuar mund të reduktojë ndikimin e florës mbi faunën lokale. Rajoni i Durresit ka një gamë të gjerë flore dhe faune; ekzistojnë rreth 1600 specie bimësh me përqindje të lartë në raport me sipërfaqen e rajonit. Flora e zonës është e pasur me pemë të tilla si lisi, ahu, pemë halore, si dhe pemë frutore si hurma, kumbulla, shega, mana, kajsia e rushi e shumë bimë të tjera dekorative.*

*Përveç shkarjes së tokës, shkatërimi i pyjeve nuk do të thotë vetëm humbje pemësh, por edhe humbje e diversitetit si pasojë e humbjes së zonave të habitatit dhe të zonave ushqyese.*



### 3. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

#### 3.1. Burimet ujore ne zone

Me zgjerimin e qytetit, zona midis lumenjve tashmë është urbanizuar plotësisht dhe zhvillimi është shtrirë në kodrat përreth qytetit. Korridori verior drejt bregdetit, i cili lidh Tiranën me Durrësin ka njohur gjithashtu zhvillim të madh me një përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Bashkia e Durresit vlerëson se tani zona urbane zë rreth 40 për qind të luginës, ndërsa ekspansioni urban po kap edhe kodrat përreth. Ndërtimet në perëndim, në Malin e Dajtit janë një problem serioz, ku shpyllëzimi dhe urbanizimi, përveç përkeqësimit estetik të zonës, pritet të rrisë nivelin e rrëshqitjeve dhe mund të paraqesë rreziqe serioze përmbetjeje për qytetin.

**Zona ne studim nuk prek asnje burim uhor apo devijon vijen ujore te kanaleve kryesore te kullimit si dhe nuk ndodhet prane burimeve ujore.**

Ne kete studim, i cili kryhet ne kuadrin e pajisjes me Leje Mjediore Tipi B per Prodhim te produkteve farmaceutike, Bashkia Durres.

#### 3.2. Karakteristika të rjetit hidrografik të Bashkise Durres

Një aspekt pozitiv i Durresit është se ajo ka burime të mjaftueshme ujore për t'iu përgjigjur kërkesave aktuale. Durresi furnizohet, me ndërprerje, nga katër burime sipërfaqësore dhe rreth tetë burime nëntokësore. Burimet sipërfaqësore mbulojnë rreth 50 për qind të furnizimit në vitet e thata, e deri në 80 për qind në vitet e lagështa. Rezerva aktuale e dokumentuar rezulton të jetë 3,000 litra në ditë, e cila, edhe duke hamendësuar një popullsi të Durresit deri në 1 milionë, do të siguronte 260 litra për person në ditë. Kjo sasi uji është e mjaftueshme për t'iu përgjigjur kërkesave familjare dhe jo-familjare të qytetit. Megjithatë, sasia e furnizimit me ujë është e pamjaftueshme për t'iu përgjigjur kërkesave, ndërsa cilësia e ujit është poshtë standardeve të pranuar.

Problemet duket të jenë një kombinim çështjesh teknike dhe institucionale. Sipas vlerësimeve të bëra, rreth një e treta e ujit humbet në burim.<sup>1</sup> Sistemi i furnizimit me ujë është i vjetër dhe punon shumë nën kapacitet, ndërkohë që ka dhe shumë rrjedhje. Rreth 45% e ujit mendohet të jetë i pajustificuar, por nuk dihet një shifër e saktë, pasi nuk ekziston informacion i saktë në lidhje me lidhjet ilegale. Ka shumë lidhje ilegale dhe në tubacionet kryesore të ujit ndërhyhet me lidhje për përdorim të ujit në bujqësi. Veç kësaj, shumë nga puset, të cilët janë fare të cekët, janë të ndotur prej vendbanimeve lokale. Ndaj dhe shifra në lidhje me sasinë e pajustificuara të ujit, apo humbjeve, ka shumë mundësi të jetë shumë më e madhe se 45%.

Uji sigurohet me ndërprerje dhe sistemi operon me presion të ulët. Ndërkohë që një gjë e tillë ul humbjet, ajo nxit në të njëjtën kohë përdorimin e pompave të ujit për përdorim shtëpiak, për të thithur ujin nga tubat, gjë që deformon funksionimin hidraulik të sistemit. Shumë shtëpi kanë depozitat e tyre

<sup>1</sup> Technical and Financial Assistance to the Greater Tirana Water Supply Sewerage Enterprise, Master Plan, Ministry of Territorial Adjustment and Tourism, General Directorate of Water Supply and Sewerage, 2002

vetjake që sigurojnë një furnizim *de-facto* 24 orësh. Investimet në pompa e depozita flasin gjithashtu dhe për skepticizmin e publikut në lidhje me aftësinë e qeverisë për t'u siguruar furnizim të mjaftueshëm me ujë. Kjo, në njëfarë mase, konfirmohet nga fakti se Ndërmarrjet e Ujësjetllësit dhe e Ujërave të Ndotura duket të jenë për momentin në një situatë institucionale të paqartë. Më përpara ato ishin nën varësinë e Ministrisë së Ekonomisë, por sipas një ligji të vitit 2002, këto ndërmarrje duhej të kalonin në varësi të pushtetit lokal.

Monitorimi i cilësisë së ujit në lumenjtë kryesorë të Shqipërisë është ndërmarrë nga Instituti i Shëndetit Publik deri në vitin 2003. Që nga viti 2004, monitorimi kryhet nga Instituti i Mbrojtjes së Mjedisit, në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Departamenti i Higjienës, në Ministrinë e Mjedisit, kryen analizat e cilësisë së ujit në kanalizime, kryesisht tepricat e klorit dhe disa parametra fizikë. Ai ka të drejtën të bllokojë furnizimin me ujë dhe të gjobisë Ndërmarrjen. Megjithatë, ata janë të ndërgjegjshëm për kufizimet në të cilat funksionon Ndërmarrja dhe e mirëkuptojnë këtë gjë.

#### 4. IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR, PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE SI DHE INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA,

##### 4.1. Ndikimet e mundshme mjedisore Ndikimet pozitive mjedisore dhe përfitimet

Ndikimin më të dobishme të këtij projekti është përmirësimi i rëndësishëm për shëndetin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës për të gjithë komunitetin të Durrësit të cilët do të përfitojnë nga reabilitimi dhe sistemimi në një furnizim rrjetëzor dhe cilësi të ujit të pijshëm të mirë lidhur edhe me përmirësimin e infrastrukturës sanitare edhe pse projekti është i një permase të vogël ku ndikimi pozitiv që mund të ndihet nga zhvillimi i këtij projekti është në permase të vogla. Projekti do të sigurojë furnizim të besueshëm të cilësisë së ujit të pijshëm, pa të cilat njerëzit dhe industria do të kishin cilësinë e ujit të dobët dhe furnizime të kufizuar në raste të një menaxhimi jo cilësor dhe konform kërkesave të konsumatorit. Projekti do të lehtësohet në përmirësimin e kushteve të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore në zonat urbane, të cilat, në qoftë se nuk kontrollohen dhe monitorohen duke u dërdhur në rrjedhje lumore ato do të rezultojnë në kripësi të rritur dhe ndotjen e ujërave që përdorin ujërat nëntokësore. Projektet mund të priten që të sjellë përfitime të rëndësishme për të dhe suburbane zonat urbane të Durrësit, duke ulur % për mungesat e ujit dhe përmirësimin e cilësisë e sigurisë (ujëra konform kushteve higjienore sanitare) dhe besueshmërinë e furnizimit me ujë për përdorim shtëpiak dhe për ujtitje. Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë do të mbështesë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të rajonit Durres dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardit të jetesës së zonave rurale banorët e qytetit e urbane. Përfitime të konsiderueshme shëndetësore mund të jenë të parashikuara, për shkak të ekspozimit të rënë për sëmundjet, veçanërisht me efikasitet mbledhje të ujërave të zeza, duke çuar në përmirësimin e cilësisë së ujit dhe menaxhimin e ujërave të bardha. Nënprojektet do të rezultojnë në krijimin e drejtpërdrejtë të mundësive se punësimi me kohë të plotë gjatë periudhës së ndërtimit dhe punë të përhershme në objektet e projektit të ri, ky faktor do të vlerësohet saktë gjatë fazës së II të zhvillimit të projektit.

##### Impakti në mjedisin humane nga rrezatimi

**Impakti nga ndërtimi:** gjatë procesit të punës së ndërtimit në terren nuk do të ndikohet nga rrezatimi i fushës elektromagnetike.

**Masa parandaluese:** Në lidhje me rrezatimin jonizues të linjave elektrike, intensiteti i fushës elektrike në një lartësi 1.8m nga sipërfaqja e tokës, me një varg tërlesh me lartësi të kalueshme, nuk e kalon 5kV/m dhe me 1kV/m jashtë zonës buferike të sigurisë, matje të tjera të detajuara dhe perilogartije të sakta do të jenë të nevojshme të realizohen për të mbrojtur mjedisin social dhe natyral, edhe pse këto janë pjesë plotësuese të projektit kryesor.

Për instalimet që janë pjesë në zonën me bimesë janë të pajisur me zjarre kontrollues, sistem ventilimi dhe gjenerator kur është e nevojshme, rrufe prites, dhe sinjali i paralajmërimit.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri do të realizohet sipas normave ligjore të Republikës së Shqipërisë, Evropës dhe normave e rregullave nga praktika teknike.

Perfundimisht mund të thuhet se për këto arsye masat nuk janë të kërkuara, sepse impakti është i papërfillshëm pasi prezenca e banoreve pranë kësaj zone është e papërfillshme.

### **Paraqitja e masave për mbrojtje nga zjarri**

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri do të realizohet sipas normave ligjore të Republikës së Shqipërisë, Evropës dhe normave e rregullave nga praktika teknike.

Mbrojtja nga zjarri është projektuar si instalim statik/fiks dhe do të lidhet në sistemin e hidrantit, i cili furnizohet me ujë nga depoja e ujit për zjarr-fikje. Kapacitetin dhe presionin në rrjetin e hidrantit e sigurojnë pompat të vendosura në stacionin e pompave. Në sistemin e mbrojtjes nga zjarri janë parashikuar këto masa teknike për mbrojtje nga zjarri:

- Furnizimi me ujë për nevojat e mbrojtjes nga zjarri
- Rrjeti i jashtëm i hidrantit me hidrantët mbitokësore dhe ormanët për hidrant
- Pajisjet statike për mbrojtje nga zjarri në çdo objekt
- Aparatet për zjarr-fikje
- Sistemi i alarmit të zjarrit (centrali) dhe lajmëruesit/detektorët në pika të ndryshme të instalimeve
- Butonat e alarmit në raste emergjente
- Pajisjet mobile për zjarr-fikje
- Mjetet për zjarr-fikje u mundësohet hyrjeve

### ***Furnizimi me ujë për mbrojtjen nga zjarri***

Stacioni i pompave të ujit për zjarr-fikje furnizohet nga depozitat e ujit për zjarr-fikje. Gypi shtytës nga pompat është i lidhur në rrjetin e hidrantit. Rezervuari i ujit për zjarr-fikje furnizohet nga depozita me ujë. Niveli mbahet me notues. Në rrjetin e hidrantit është lidhur instalimi për ftohjen e objekteve si dhe dozatorët e shkumës me instalime për shpërndarjen e përzierjes për shuarjen e zjarrit në objektet përkatëse.

### ***Stacioni i pompave dhe rezervuari i ujit për fikje zjarri***

Gjate dimrit, kur temperatura bie nën 5 °C objekti nxehet me kalorifer elektrik. Do të montohen 1 pompe me ndezje elektrike. Secila pompë ka kapacitet prej 0.1m<sup>3</sup>/h. Nje pompa punojnë ndërsa e treta është rezervë. Në kushte normale presioni në sistemin e hidrantit mbahet përmes hidrovorit. Ky stabiliment mundëson edhe një shpenzim të vogël të ujit për nevoja të serviseve. Hidrofori përbehet nga ena me vëllim prej 3000 l dhe pompa me 0.25 m<sup>3</sup>/h. Pompa kyçet dhe shkyçet nga presostati. Vlerat e presionit për kyçje të pompave kryesore dhe atë të hidroforit do të përcaktohen me projektin kryesor. Pranë enës së hidroforit gjendet edhe kompresori, i cili ruan presionin në enën e hidroforit. Dalja nga kompresori është e kyçur në maje të enës së hidroforit. Furnizimi i pompave të përmendura me energji elektrike bëhet nga dy burime. Furnizimi normal është nga transformatori, ndërsa furnizimi kur mungon energjia elektrike bëhet nga gjeneratori me naftë. Për nevoja të akumulimit të ujit për mbrojtje nga zjarri është parashikuar rezervuari me vëllim prej 0.25 m<sup>3</sup>. Kjo sasi mundëson mbrojtjen nga zjarri (sipas DIN 14993-100). Rezervuari i ujit për fikjen e zjarrit furnizohet nga autobot që do të pajiset me lejet e vecanta që do të kerkohen. Operatori vazhdimisht kontrollon nivelin e ujit në rezervuar përmes nivel matësit. Rezervuari është pajisur me notues (valvola për hapje e mbyllje me notues).

***Rrjeti i hidrantit***

Për rreth objekteve vendoset rrjeti i hidrantit me hidrantë mbitokësor. Rendiija dhe numri i hidrantëve mbitokësor do të përcaktohet ashtu që të plotësohen kërkesat e përcaktuara më norma dhe rregullore për mbrojtje efikase.

***Lajmërimi i zjarrit***

Në depozite do të vendosen lajmëruesit manual dhe ato automatik të zjarrit. Impulsi nga lajmëruesi i zjarrit në centralen e zjarr-fiksve e kyç sinjalizimin vizual dhe atë akustik. Rendiija e lajmëruesve të zjarrit dhe përshkrimi i punës së sistemit lajmërues do të përpunohen në projektin kryesor. Po ashtu është parashikuar edhe instalimi telefonik i cili është e lidhur në rrjetin publik përmes centralit.

## 5. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË

**A.Ndikimet:** Ky raport i VNM tregon se zbatimi i rehabilitimit e zones ku do te ndertohet si dhe përmirësimin e rrjetit inxhinierik si sistemi i furnizimit me ujë dhe mbledhjen e ujërave të zeza dhe të sistemit të trajtimit për kete projekt nuk ka gjasa të shkaktojë ndikime të rëndësishme negative në mjedis gjatë ndërtimit dhe funksionimit në nivele afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe per çdo ndikim të vogla që janë të lidhur me ndërtimin e projektimit, dhe funksionimin e nën-projekteve të propozuar te cilat mund të zbutet pa vështirësi përmes projektimit inxhinieri dhe inkorporimin e duhur ose zbatimin e masave lehtësuese të rekomanduara dhe procedurat në të gjitha fazat në përputhje me studimet lokale dhe rajonale e cila do te jete pjese integrale e raportit final te VNM-se.

**B . Përfitimet e projektit** do të përfitojnë në mënyrë të konsiderueshme dhe periferike zonat urbane të Durrës përmes përmirësimeve të infrastruktures inxhinierike ne zone.

**C. Ndikimet e mundshme negative dhe masat zbutëse efektet negative** të projektit do të shmangen ose të zvogëlohen në nivele të pranueshme duke marrë masa për zbutjen e duhura dhe kompensim. Masat kryesore përfshijnë (i) përzgjedhje të kujdeshme të nenprojekteve dhe projektim konform PMM(EMP), te SHI për të shmangur vende të ndjeshme, (ii) kontrollin e zhurmës, pluhurit, dhe lirim in e ujërave të zeza gjatë ndërtimit, dhe (iii) rehabilitimi dhe rigjelberim pas përfundimit të projektit.

**D. Masa të tjera për të plotësuar Planin sektorial jane:** Gjatë përgatitjes së VNM janë identifikuar disa masa plotësuese të cilat ose trajtojnë mangësitë në informacionin mjedisor, ose janë të nevojshme për të pasur progress në përmirësimet mjedisore. Ato renditen më poshtë dhe përmbajnë përshkrime të nevojave dhe qëllimeve të ndërhyrjes, si dhe të agjensive që mund ta kryejnë më mirë zbatimin e tyre.

Në vijim renditen masat e sugjeruara:

- Vleresimi për të bërë lidhjen mes treguesve të shëndetit dhe aspekteve të mjedisit.- Ky është një studim i domosdoshëm për të bërë vlerësimin e kostove ekonomike dhe shëndetsore që problemet mjedisore të fushes se ndertimit te objekteve qe sjellin për Shqipërinë. Ai do të mundësojë drejtimin e investimeve në fushat prioritare, ku mund të arrihen edhe përfitimet më të mëdha. Studimi do të bëjë vlerësimin e shtrirjes së problemeve shëndetsore dhe mjedisore dhe do të identifikojë dhe shprehë në shifra lidhjen mes tyre, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e faktorëve të jashtëm, si psh: ndryshimet e mikroklimës. Megjithëse do të përqëndrohej kryesisht në cilësinë e ajrit, ai do të bënte edhe vlerësimin e problemeve të tjera mjedisore.
- Për disa nga rrjetet e reja te furnizimit me uje të propozuara është e nevojshme kryerja e një analize më të detajuar mjedisore. – Projektet e reja të propozuara ndodhen ose në zona urbane ose në kryqëzime rrugësh. Zona urbane kanë një trashëgimi të zhvillimit urban **por jo projekti ne vleresim**, por disa na këto qendra ndodhen në zona me ndjeshmëri mjedisore, sidomos ne zonat e me status arkeologjik apo kulturor.
- Studimi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta – Është i nevojshëm një plan lokal me qëllim që të identifikohen mjetet dhe mundësitë për reduktimin e mbetjeve dhe rritjen e riciklimit, duke përfshirë këtu edhe përdorimet alternative të mbetjeve; dhe vi) të rekomandojë rregullime institucionale dhe financiare për këto propozime. Kjo mund të menaxhohet nga subjekti ndertuese perfs hire edhe largimin e mbetjeve inerte nepermjet subjekteve te licensuar, si fushate sensibilizuese ne zonen e vete te studimit por nënkupton bashkërendimin e punës me MTM, MTI dhe me njësitë e pushtetit vendor.

- Studimi i trashëgimisës së ndërtimit. – Kjo propozohet në plani dhe nëpërmjet identifikimit dhe regjistrimit të PDV se zhvillimit të rajonit, gjendjes së tyre dhe propozimit të masave për t'i ruajtur dhe mirëmbajtur ato.
- Mbështetje për Shtrirjen e GIS në monitorimin e zbatimit dhe ndikimeve mjedisore të SHI. – Monitorimi efektiv i ndikimeve mjedisore të planit kërkon që GIS të shtrihet dhe të mbulojë një sipërfaqe më të madhe se ajo aktuale. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në monitorimin e zbatimit dhe do të shërbejë si studim paraprak për planet lokale të zonave rreth qytetit. Sigurisht zona shtrihet brenda kufijve të Bashkisë së Durres, ku infrastruktura është në pronësi të njësive të tjera vendore dhe menaxhohet prej tyre, megjithëse furnizimi me ujë mbulohet nga një ndërmarrje e vetme. Megjithatë, një qasje e tillë për shtrirjen dhe menaxhimin e GIS do të kthehet në një mjet efektiv për përmirësimin e bashkëpunimit mes pushteteve të ndryshme vendore dhe do të përbente një hap të rëndësishëm drejt planifikimit më të koordinuar me disa qendra zhvillimi.
- Një studimi i mikro-klimës mund ta plotesonte studimin e VNM nëpërmjet ofrimit të dhënave shtesë lidhur me ndikimin e përqëndrimeve dhe zhvillimit. Rekomandohet të rishikohet si mundësi studimi në fazën kur pusheti vendor të përgatit PPV.
- Në të njëjtën mënyrë edhe prodhimi i energjisë së gjelbër (shfrytëzimi i mundësive të energjive të rinovueshme) është një fushë që mund të inkurajohet nga ligjet e planifikimit dhe të taksave.

## 6. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Para sëgjithash do të doja të informojme se ky projekt(Prodhim te produkteve farmaceutike) **nuk do te kete ndikime te mundshme nderkufitare** per vete faktin se zone ku do te ndertohet objekti ne Shijak Durres (Zona e njohur si zona Koxhar) eshte zone e urbanizuar me destiancion komercial, ku ndertimi i tij eshte nga burimet qe rrjedhin dhe krijohen brenda territorit te shtetit Shqipetar.

Rregullimi i kësaj çështje, pra i mënyrës se si menaxhohen ujërat dhe ndikimet ndërkufitare, janë çështje, të cilat adresohen në mënyrën më të plotë të mundshme, në një kuadër të mirëpërcaktuar nga e drejta dhe praktika ndërkombëtare, të cilat janë të detyrueshme si për Shqipërinë, ashtu edhe për vendet fqinje. E, këtu nuk ka asnjë rast qe ku segment(me siperfaqe ndertimi 4 407.0 m<sup>2</sup>) te jete pjese e ujerave territorial nderkombetar apo e ndikimit ne shkarkimit ne ajer ne nivele te tilla kombetare dhe nderkombetare.

Së dyti, vendi yne aspiro anëtarësimi në BE. Kanë një marrëdhënie kontratuale në BE, që është marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe përkatësisht kanë detyrime, në lidhje me regjimin e ujërave dhe janë të detyruara që të zbatojnë normativën që burojnë nga direktivat e BE, edhe pse ky projekt nuk vlerësohet ne kete faze si i tille, por mbetet per tu rivleresuar nga AKM.

Në bazë të konventave ndërkombëtare ujërat ndërkufitare duhet shfrytëzohen në një mënyrë të arsyeshme dhe të barabartë, duke marrë në konsideratë të veçantë karakterin e tyre ndërkufitar, në rast se aktivitetet që shkaktjnë ose kanë të ngjarë të shkaktjnë, kanë një impakt ndërkufitar.

Pala shqiptare, qeveria e Republikës së Shqipërisë, i diskutojnë problemet që lidhen me shfrytëzimin tërësor të ujërave, jo thjesht me Italine apo Greqine, por me çdo vend tjetër me të cilin ka një problematikë përkatëse, veçse në frymën e së drejtës ndërkombëtare, veçse në frymën e mirëkuptimit në marrëdhëniet dypalëshe, të marrëveshjeve dypalëshe dhe të gjitha detyrimeve që shtetet kanë në këtë drejtim.

Ky projekti gjate fazes se zhvillimit do të mbrojë mjedisin natyror kombetar, integritetin territorial dhe gjithë interesat e kombit shqiptar qe mund te preken nga ky projekt.